



PARLAMENTI I KOSOVËS  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**Nr. 392/2 Protokolli**

**Datë 09.03.2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.03.2021 me:

**Objekt:**

1. Urdhër për pezullim procedure ankandi
2. Shqyrtim në themel

**Subjekte të interesuar:**

Bashkia Shkodër  
Rruga 13 Dhjetori, nr 1, Shkodër

“Colosseo Construction” shpk  
Lagjia “3 Heronjtë”, Rruga Marin Bicikemi,  
Shkodër

Agjencia e Prokurimit Publik  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Këshilli i  
Ministrave, Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik” i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e

rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes dhe shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

### **Vëren**

1. Respektimin *prima facie* të kushteve formale
2. Kandidati blerës “Colosseo Construction” shpk kërkon modifikimin e dokumentave të procedurës së ankandit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Bashkia Shkodër shet me procedurë ankandi aksionet e Klubit të Futbollit “VLLAZNIA” sh.a, në masën 100%.*”, me vlerë fillestare 50,794,000 (pesëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.03.2021, nga autoriteti shitës Bashkia Shkodër.

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës si dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

### **Arsyeton:**

Ankesa e operatorit ekonomik “Colosseo Construction” shpk është *prima facie*, e bazuar

Sa më sipër në mbështetje të nenit 43 të ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 “*Per Ankandin Publik*” të ndryshuar, dhe nenit 27 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” , Komisioni i Prokurimit Publik,

### **Vendos**

1. Të kalojë për shqyrtim ankesën e operatorit ekonomik “Colosseo Construction” shpk për procedurën e ankandit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Bashkia Shkodër shet me procedurë ankandi aksionet e Klubit të Futbollit “VLLAZNIA” sh.a, në masën 100%.*”, me vlerë fillestare 50,794,000 (pesëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.03.2021, nga autoriteti shitës Bashkia Shkodër.
2. Të urdhërojë pezullimin e procedurës së ankandit dhe moskryerjen e asnjë veprimi nga autoriteti kontraktor deri në shqyrtimin e ankesës dhe marrjen e vendimit përfundimtar.
3. Autoriteti Shitës të dërgojë menjëherë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të ankandit dhe fazën në të cilën ndodhet kjo procedurë, dokumentat e ankandit të shoqëruara me procesverbalin e hartimit dhe

argumentimit të kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve teknike; gjithashtu të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e kandidatit blerës “Colosseo Construction” shpk” sh.p.k., si dhe informacion i hollësishëm vërtetuar me dokumentacion për dorëzimin e ankesës pranë autoritetit shitës dhe trajtimin e saj.

4. I gjithë informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar, të paraqitet jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së këtij vendimi dhe të jetë shoqëruar me një Proces-Verbal në të cilin të pasqyrohet emërtimi i dokumentave me numrin e fletëve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

